



**KLUBI I KARATESË "ULQINI"**  
**KLUBI I KARATESË "ALBULENA"**



**organizojnë:**

# **TURNEUN E X NDËRKOMBËTAR "ULQINI OPEN 2009"**



**pjesëmarrësit e vitit të kaluar**



**FK MZ**



**E.K.F.**

**ME RASTIN  
E DITËS SË ULQINIT  
E SHTUNA E PARË E PRILLIT**

**Ulqin, më 05.04.2009**

**Mali i Zi**

**Mirë se vini!**



## Të nderuar miq të sportit!

Ju ftojmë që të merrni pjesë në Turneun e X jubilar ndërkombëtar të karatesë “**ULQINI OPEN 2009**”, i cili organizohet me rastin e Ditës së Ulqinit.

Vitin e kaluar në turneun tonë morën pjesë 39 klube me 830 garues nga Mali i Zi, Shqipëria, Kroacia, Bosna, Serbia, Maqedonia dhe Kosova dhe me këtë u bë turneu më masovik i karatesë në Mal të Zi në vitin 2008.

Qyteti ynë i bukur është i njohur jo vetëm si destinacion i preferuar turistik, por edhe si qytet me një traditë të gjatë sportive. Siç njihet për detin, diellin, ullinjtë dhe plazhet e mrekullueshme zallore, Ulqini njihet edhe në sportin e karatesë falë sukseseve të mëdha të arritura në arenat vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare. Që të njiheni me bukuritë dhe historinë e qytetit tonë vizitoni faqen e internetit [www.ulqini.de](http://www.ulqini.de).

Prania Juaj në turneun tonë do të na nderojë dhe do ta bëjë edhe më madhështore kremtimin e Ditës së Ulqinit.

Ju urojmë qëndrim të këndshëm në qytetin tonë dhe shumë medalje!

## Përshëndetje sportive!

**KK “Ulqini” dhe KK “Albulena”  
organizatorët e turneut**



# TURNEU I X NDËRKOMBËTAR "ULQINI OPEN 2009"

**Vendi:** Shkolla fillore "Marshali Tito", Ulqin, Mali i Zi  
**Organizatorë:** FKMZ, Klubi i karatesë "Ulqini", Klubi i karatesë "Albulena" - Ulqin  
**Data:** e shtunë, 5 prill 2009  
**Patron:** Komuna e Ulqinit

**Paraqitjet:** deri më 3 prill 2009 në orën 18:00  
**FKMZ fax:** +382 (0)20 648-411  
**E - mail:** [karatesavezcg@cg.yu](mailto:karatesavezcg@cg.yu)  
**KK "Ulqini" fax:** +382 (0)30 412-956  
**E - mail:** [arditarama@t-com.me](mailto:arditarama@t-com.me); [karateul85@hotmail.com](mailto:karateul85@hotmail.com); [ishakju@yahoo.com](mailto:ishakju@yahoo.com)

## **SHPËRBLIMET:**

Për tre vendet e para **medalje dhe diploma** /dy vende të treta/.

## **Kupa:**

- për të gjithë fituesit ekiporë në kata dhe luftëra,
- për garuesin dhe garuesen më të suksesshme,
- për tre klubet më të suksesshme në plasmanin gjeneral,
- për tre vendet e para në kategoritë open.

## **Shpërblimet në të holla:**

- për garuesin dhe garuesen më të suksesshme nga **150 €**,
- për tre klubet më të suksesshme në plasmanin gjeneral: **vendi i I 400 €**,  
**vendi i II 300 €**, **vendi i III 200 €**,
- për tre vendet e para në kategoritë open: **vendi i I 150 €**, **vendi i II 100 €**,  
**vendi i III 70 €**.

**Organizatorët e turneut nuk marrin pjesë në zgjedhjen e plasmanit gjeneral.**

**KOTIZIMI:** Paraqitja individuale **8.00 €**  
Paraqitja ekipore **12.00 €**

## **ORARI:**

8:00 – 9:00 – paraqitja e ekipeve  
9:00 – 9:30 – fillimi i garës

## **INFORMATAT PËR AKOMODIM:**

Skender Tahiri +382 (0)68 031 513

## **INFORMATAT PËR TURNE:**


Kryetrajneri i KK „Ulqini“ Ruzhdi Rama +382 (0)69 444 570  
Kryetrajneri i KK „Albulena“ Agron Ujkashi +382 (0)69 513 972

Kryetari i KK „Ulqini“  
Loro Nrekiq



Kryetari i Këshillit Organizativ,  
Gjorgje Daboviq

Kryetari i KK „Albulena“  
Meto Zenka



# DISIPLINAT GARUESE

## KATA INDIVIDUALE – VAJZAT DHE DJEMTË

grupmosha	niveli i I	niveli i II
2002 <sup>e më të rinj</sup>	të gjithë brezat	XXXXXXXXXX
2001/00	i verdhë - portokalli	i gjelbër - i kaltërt - i kaftë
1999/98	i verdhë - portokalli	i gjelbër - i kaltërt - i kaftë
1997/96	i verdhë - portokalli - i gjelbër	i kaltërt - i kaftë - i zi
1995/94	i verdhë - portokalli - i gjelbër	i kaltërt - i kaftë - i zi
1993/92	WKF	
1991 <sup>e më të vjetër</sup>	WKF	

## KATA EKIPORE

2000 <sup>e më të rinj</sup>
1999/98
1997/96
1995/94
1993 <sup>e më të vjetër</sup>

## RREGULLAT WKF – FKMZ– PJESËRISHT TË MODIFIKUARA

Të gjithë garuesit (përveç **1993/92** dhe **1991** e më të vjetër) punojnë kata sipas dëshirës.

**2002** e më të rinj

me të drejtë përsëritjeje të të njëjtës katë

**2001/98** niveli i I

mund të përsërisin të njëjtën katë në çdo xhiro të dytë

**2001/98** niveli i II

mund të përsërisin të njëjtën katë në çdo xhiro të tretë

**1997/94** niveli i I

mund të përsërisin të njëjtën katë në çdo xhiro të tretë

**1997/94** niveli i II

pa të drejtë përsëritjeje

**1993/92** dhe **1991** e më të vjetër punojnë sipas rregullave të WKF

**Bunkai** nuk është i detyrueshëm, por mund të punohet.

# DISIPLINAT GARUESE

## LUFTËRA INDIVIDUALE

grupmosha	vajzat	djemtë
1999/98	-30/-35/+35	-35/-40/+40
1997/96	-35/-40/+40	-40/-45/+45
1995/94	-45/-50/+50	-55/-65/+65
1993/92/91	-53/-59/+59	-61/-68/+68
1990 <sup>e më të vjetër</sup>	-53/-60/+60	-68/-78/+78
juniorët - seniorët	open	open

## LUFTËRA EKIPORE

1999/98
1997/96
1995/94
1993/92/91
1990 <sup>e më të vjetër</sup>

**Kohëzgjatja e luftërave:** 1999/98 - 1 min, 1997/94 - 1.5 min, 1993/92/91 - 2 min, 1990 e më të vjetër - 3 min.

**Ekipi numëron 3+1 garues.**

Çdo garues duhet të ketë pajisjet sipas rregullores.

Çdo garues merr pjesë në përgjegjësi të vet. Organizatori nuk merr përsipër përgjegjësinë në rast të lëndimeve eventuale.

Trajnerët duhet të kenë pajisjet sportive dhe akreditivin e marrë nga organizatori, në të kundërtën nuk mund të qëndrojnë në parket.

Çdo klub mund të delegojë referin, por Komisioni i referëve i FKMZ mban të drejtën e zgjedhjes së referëve.

Referët do të jenë të njoftuar në kohë.

**Vërejtje:** Për të dhënat e sakta të garuesve (grupmosha dhe pesha) janë përgjegjës përfaqësuesit e klubeve. Në rast dyshimi bëhet kontrolli dhe diskualifikimi i garuesit.

**Gara zhvillohet në 5 arena.**